Kah po shkon Kosova?

Përmbajtja:

- Serbia është e interesuar për territore dhe resurse;

- Decentralizimi në Kosovë është projekt i Serbisë;

- Pasojat e decentralizimit në Kosovë: Policia e ndarë; Gjyqësia e ndarë; Arsimi i ndarë; Shëndetësia e ndarë; Financimi; Rikolonizimi.

- Decentralizimi i këtij lloji është largim i pushtetit nga qytetari;

Decentralizimi në Kosovë është projekt i Serbisë…!

Nga **Sheradin Berisha**

- Negociatat e ardhshme UNMIK-Serbi-Kosovë, për Autonomin e zgjeruar serbe!

*** * ***

· Decentralizimi në Kosovë është projekt i Serbisë, i cili nëpërmjet UNMIK-ut u bë edhe projekt i Qeverisë së Kosovës. E filloi qeveria Rexhepi me ministrin e atëhershëm Jakup Krasniqin, e vazhdoi qeveria Haradinaj e pastaj Kosumi me ministrin Lutfi Haziri, punë kjo që nuk u ndal aspak me qeverinë Çeku sërish me Lutfi Hazirin, dhe projekt i cili po e gjen kurorëzimin e tij me qeverinë aktuale Thaçi, me ministrin e pushtetit lokal, Sadri Ferati. Përgjatë negociatave në Vjenë është diskutuar kryesisht për territore. Bile ky ka qenë diskutimi kryesor. Jorastësisht në Planin e Ahtisaarit më së shumti hapësirë zë pjesa që flet për vetë hapësirat: projekti i decentralizimit. Pakoja e Ahtisaarit i definon qartë kufijtë e komunave të reja me shumicë serbe.

Harta e papërkryer e decentralizimit të Kosovës sipas projektit të Serbisë

Serbia është e interesuar për territore dhe resurse

Serbia gjithnjë ka qenë dhe është e interesuar për territore dhe resurse. Asaj asnjëherë nuk i kanë interesuar njerëzit sa këto dyja. Njësia elementare operative e politikës shtetërore serbe është kilometri, shtrirja, hapësira. Në historinë serbe je hero për aq sa i ke zgjeruar territoret e shtetit nëpërmjet pushtimit. Në Kroaci Serbia nuk i pranonte të drejtat e serbëve, por i donte tokat ku jetonin ata, pra që këto hapësira t'i bashkoheshin Serbisë. Në fund i humbën edhe tokat, edhe njerëzit prej atyre territoreve, meqë shumica dërrmuese e tyre u dëbuan. Por, aty ku Serbia ka mundur të fitojë territore, e ka bërë këtë punë maksimalisht. Sikur në Bosnje. Vetëm

Republika Serbe ka mbi 25 mijë kilometra katrorë. Pra rrumbullak sa Maqedonia. E udhëhequr edhe sot e kësaj dite nga politika e territorit, qëllimi i shtetit të Serbisë është krijimi i një republike serbe përbrenda Kosovës, e cila do t'i përfshinte së paku të gjitha territoret e banuara me serbë. Së paku, sepse Serbia do që t'i përfshijë brenda këtyre territoreve edhe fshatra shqiptare, të cilave më pas do t'u kërcënohej fati i veriut të Mitrovicës gjatë shkurtit të vitit 2000, kur kjo pjesë u spastrua etnikisht nga strukturat paralele të Serbisë - 11.364 shqiptarë u dëbuan, 11 u vranë. Projektin e saj për krijimin e një entiteti dhe ndarjen e Kosovës Serbia as që e fsheh: ai mund të gjendet gjithandej dokumenteve zyrtare si dhe faqeve zyrtare qeveritare të internetit. Ish nënkryetari i Serbisë, Miroljub Labus, qysh me datën 6 nëntor 2004 për gazetën Politika ka thënë: "Në kuadër të Kosovës dhe Metohisë do të duhej të formoheshin dy entitete. Entitetin serb do ta përbënin këto zona: Kosova Veriore (komuna e Leposaviqit, ZubinPotokut, Zveçanit dhe veriut të Mitrovicës) dhe Anamorava (komuna e Dardanës, Artana, Graçanica dhe pjesë të Gjilanit dhe Lipjanit)." Partia e Labusit sot udhëheq pushtetin në Serbi dhe prej të gjitha qarqeve politike perëndimore cilësohet si qeveri demokratike properëndimore. Për ta kontrabanduar këtë projekt Serbia i ka keqpërdorur veçanërisht ngjarjet e 17 dhe 18 marsit 2004. Pas këtyre ngjarjeve, në Kosovë prioriteti politik i të gjitha qeverive të derisotme ka qenë dhe është procesi i decentralizimit.

Decentralizimi në Kosovë është projekt i Serbisë

Decentralizimi është një tjetër emër politikisht korrekt për institucionalizimin e ndarjeve etnike. E kanë zgjedhur qëllimisht një term që tingëllon politikisht neutral, për emërtimin e një procesi krejtësisht serb. Një projekt, ideomi i të cilit buron nga politika serbe po mundohet të na paraqitet si i vetmi për t'i shpëtuar të drejtat e pakicës serbe, duke ia fshehur kështu fytyrën e tij të vërtetë hegjemonike. Decentralizimi është mjeti më i efektshëm për zbatimin e planit qeveritar serb për copëtimin e Kosovës.

Decentralizimi në Kosovë është projekt i Serbisë, i cili nëpërmjet UNMIK-ut u bë edhe projekt i Qeverisë së Kosovës. E filloi qeveria Rexhepi me ministrin e atëhershëm Jakup Krasniqin, e vazhdoi qeveria Haradinaj e pastaj Kosumi me ministrin Lutfi Haziri, punë kjo që nuk u ndal aspak me qeverinë Çeku sërish me Lutfi Hazirin, dhe projekt i cili po e gjen kurorëzimin e tij me qeverinë aktuale Thaçi, me ministrin e pushtetit lokal, Sadri Ferati. Përgjatë negociatave në Vjenë është diskutuar kryesisht për territore. Bile ky ka qenë diskutimi kryesor. Jorastësisht në Planin e Ahtisaarit më së shumti hapësirë zë pjesa që flet për vetë hapësirat: projekti i decentralizimit. Pakoja e Ahtisaarit i definon qartë kufijtë e komunave të reja me shumicë serbe. Këto pjesë të territorit të Kosovës së 'decentralizuar' do të kenë status autonom. Procesi i decentralizimit po shkon sipas planeve serbe për të krijuar një 'zonë sigurie' mes Luginës së Preshevës dhe Kosovës. Pjesët më të rrezikuara do të jenë:

- Zona kufitare mes Gjilanit dhe Bujanocit, në fakt brezi territorial mes fshatrave Stubllinë dhe Hodanoc (strategjikisht zonë shumë e rëndësishme për lidhjen e vendbanimeve serbe në lindje të Kosovës me Serbinë);

- Berivojca (fshat i përzier etnikisht afër Dardanës - ku dominimi etnik serb u mundëson serbëve që ta rrethojnë qytetin e dominuar nga shqiptarët -Dardanën; dhe fshatrat Ruboc, Busovatë, Makresh i Poshtëm dhe Kllobokar);

- Zajçeci (me marrjen e këtij fshati në pjesën veriore të komunës së Dardanës do të vendosej një lidhje territoriale mes Serbisë dhe fshatit të banuar me serbë që quhet Gragjenik). Decentralizimi është projekt i krijimit të më shumë pengesave ndërmjet territoreve të pashkëputshme shqiptare. Pikërisht që ato të mos kenë më vazhdimësi ndërmjet vete.

Pasojat e decentralizimit në Kosovë

Këtu më poshtë po i përmbledhim disa nga pasojat e decentralizimit, sipas mënyrës që është paraparë të realizohet në Kosovë.

Policia e ndarë

- Kuvendet komunale të komunave me shumicë serbe do të kenë të drejta të avancuara në përzgjedhjen dhe shkarkimin e komandantëve të stacioneve policore;

- Kufijtë e stacioneve policore do të jenë të njëjtë me ata komunalë;
- Policia qendrore dhe ajo speciale duhet ta njoftojnë paraprakisht komandantin e policisë komunale për operacionet që do të ndërmerren brenda territorit të stacionit;

- Përbërja etnike e policisë duhet ta reflektojë atë të komunës. Pra, jo të Kosovës!

Gjyqësia e ndarë

- Komunat e reja që do të formohen sipas procesit të decentralizimit, e që nuk kanë gjykata komunale në territorin e tyre, do të kenë të drejtë të zgjedhin se në cilën gjykatë dëshirojnë të shërbehen;

- Kandidatët për gjykatës në këto gjykata mund të nominohen vetëm nga dy anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës që janë zgjedhur nga deputetët që kanë ulëse të rezervuara/garantuara e që vijnë nga pakica serbe;

- Çfarëdo kontestimi të vendimit komunal, qeveria qendrore mund ta dërgojë vetëm në Gjykatën e Qarkut në të cilën bën pjesë komunë;

- Të gjitha këto mund të ndryshohen radikalisht me negociatat e reja sipas propozimeve të Ban Ki-moon-it

Arsimi i ndarë

- Komunat me shumicë serbe do të kenë kompetenca autonome në lëminë e arsimit;

- Në Kosovë do të ketë shkolla serbe dhe tjera;

- Shkollat serbe kanë të drejtë t'i aplikojnë planprogramet e Serbisë;

- Nuk kanë obligim madje as ta mësojnë gjuhën shqipe;

- Kuvendi komunal i Mitrovicës së Veriut do t'i ketë kompetencat për arsimin e lartë, përfshirë regjistrimin dhe licensimin e institucioneve të arsimit të lartë.

Shëndetësia e ndarë

- Mitrovica, Graçanica dhe Shtërpca do të kenë kompetenca në shëndetësinë sekondare, përfshirë regjistrimin dhe licensimin e institucioneve të shëndetësisë;
- Ato po ashtu do të jenë përgjegjëse për rekrutimin, pagesën, dhe trajnimin e personelit mjekësor për këto institucione.

Financimi

- Të hyrat vetanake (tatimet në pronë, taksat e regjistrimit të afarizmit, licencimin e tyre, licencimin e veturave);

- Të hyrat nga buxheti i Kosovës (Buxheti i Kosovës do t'i financojë kompetencat shtesë);

- Grantet nga Serbia (janë të kufizuara në fushëveprim por jo edhe në shumë. Këto do të paguhen drejtpërdrejt nga buxheti i Serbisë në atë komunal);

- Privatizimi i ndërmarrjeve do të bëhet vetëm pasi të jenë konsultuarautoritetet komunale në territoret e të cilave gjendet ndërmarrja.

Rikolonizimi

- Decentralizimi është në funksion të 'kthimit të qëndrueshëm', i cili bëhet edhe në funksion të decentralizimit;

- Serbia planifikon t'i kthejë serbët në ato vendbanime ku ata janë shumicë për ta theksuar atë, ku kthimi do t'i bënte shumicë (Osojan, Gorazhdec, etj.), ose aty ku i shërbejnë për lidhje të enklavave (Badoc, Berivojcë, etj.)

- Kthimi po bëhet pa kushtëzim paraprak për t'i pranuar institucionet e Kosovës. Pra, kthimi po i forcon strukturat paralele. Decentralizimi i kësaj forme është centralizim i pushtetit të Beogradit nëpër territoret e banuara me serbë sepse pushteti nuk u shkon qytetarëve, por strukturave paralele të Beogradit.

Decentralizimi i këtij lloji është largim i pushtetit nga qytetari

Këtë më së miri e ilustrojnë fshatrat Koretishë dhe Stanishor të cilat e kanë komunën e Gjilanit te dera e shtëpisë, kurse nëpërmjet decentralizimit po i fusin në komunën e Novobërdës, të cilën e kanë larg mbi 20 kilometra.

Shiko hartën: fshatrat Koretishë dhe Stanishor krejt afër Gjilanit, ndërsa me decentralizim futen në komunën e Novobërdës !!!

- Komunat e para me shumicë serbe u krijuan në kohën e Milosheviqit (Zveçan, Obiliq, etj.)

- Në shtator të vitit 2002 Qendra Koordinuese e Qeverisë së Serbisë doli me dokumentin "Baza e platformës politike të decentralizimit demokratik në Kosovës për fuqizimin e qeverisjes lokale të komuniteteve vendore, kombëtare dhe rajonale";

- Në vitin 2002 Michael Steiner në kuadër të planit shtatëpikësh për Mitrovicën u premtoi serbëve decentralizimin.

- Më 2004 decentralizimi u shndërrua në prioritet absolut politik të qeverive të Kosovës;

- Më 20 korrik të vitit 2004 Jakup Krasniqi, atëbotë Ministër i Shërbimeve Publike dhe Petr Ivantsov, Drejtor për Çështje Politike në UNMIK, nënshkruajtën draftin e parë të dokumentit për decentralizimin;

- Prania e armatës serbe në Luginën e Preshevës është e domosdoshme në mënyrë që serbët e Anamoravës të ndihen të sigurt - Nebojsha Qoviq, ish udhëheqës i Qendrës Koordinuese të Serbisë për Kosovën, 20 janar 2005, Radio B92;

- Përmes procesit të decentralizimit Serbia synon t'i pushtojë majat më të larta në rajonet ku krijohen komunat e reja: Mali Mokna në Burim. Letnica në Viti.

Negociatat e ardhshme UNMIK-Serbi-Kosovë, për Autonomin e zgjeruar serbe!

Kurse në negociatat e ardhshme UNMIK-u, Serbia dhe politikanët e Kosovës (meqë e kanë pranuar letrën e Ban Ki-moon-it) do të diskutohet autonomia e zgjeruar për serbët në:

- Gjyqësi - secili me shumicë relevante serbe do të ketë gjykata shtesë komunale dhe të qarkut;

- Polici - SHPK që operon në vendet me shumicë serbe do të jetë nën komandë ndërkombëtare;

- Dogana - pikat kufitare me Serbinë do të jenë të administruara nga ndërkombëtarët;
- Trashëgimi kulturore - ajo do të jetë nën mbikëqyrjen dhe pronësinë e drejtpërdrejt të Kishës Ortodokse të Serbisë;

- Transport dhe infrastrukturë bashkërendim teknik me Serbinë;

- Kontroll të kufirit - vazhdon të quhet vijë kufitare dhe do të mbetet nën kontroll të NATO-s.

(Gazeta javore "Vetëvendosje", Nr.151, 11 Gusht 2008)